



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.DH.SH.II.nr.1558/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Saranda Bogaj Sheremeti, anëtare të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Mili Company” ShPK me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCRL Partners” ShPK me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK), në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.257/22 i datës 24.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.05.2024, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.257/22 i datës 24.10.2023, vërtetohet.

**A r s y e t i m i**

Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.257/22 i datës 24.10.2023, është aprovuar në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Mili Company” ShPK me seli në Prishtinë, ashtu që është anuluar aktvendimi i të paditurës nr.01.3.2.2/775; 517; 1027/2019 i datës 26.08.2021 i Dogana e Kosovës në Prishtinë, dhe është obliguar e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë që paditësit “Mili Company” ShPK me seli në Prishtinë, t’ia kthej shumën 13,379.14€ (trembëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë euro e katërbëdhjetë cent), të paguar më tepër, në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratave Unike Doganore me nr. R-471/22.01.2019, R-72/08.01.2019 dhe, R-32069/21.11.2018 të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prishtina 3. Ndërsa, Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura Dogana e Kosovës, ka ushtruar ankesë për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes fakike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar me ligj, dhe prishet aktgjykimi KF.nr.257/22 i datës 24.10.2023, si i pa bazuar në ligj, si

dhe të refuzon padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar në ligj dhe lë në fuqi vendimin e kontestuar, ose t'ia kthej gjykatës së shkallës së arë në rigjykim dhe rivendosje.

I autorizuari i paditësit, shoqëria e avokateve “SCLR Partneres” ShPK në përgjigje në ankesë e konteston në tërësi ankesën, me propozim që e njëjta të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar nr.01.3.2.2/775; 517; 1027/2019 i datës 26.08.2021, është refuzuar kërkesa e subjektit në procedurë “Mili Company” ShPK-Prishtinë, për rishqyrtimin e vendimeve nr. R-471/22.01.2019, R-72/08.01.2019 dhe, R-32069/21.11.2018 të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prishtina 3, si e pa bazuara. Mbetet në fuqi vendimet/Deklaratat Unike Doganore numër nr. R-471/22.01.2019, R-72/08.01.2019 dhe, R-32069/21.11.2018 të ZBD Prishtina 3.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e Doganës së Kosovës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i paligjshëm. Dhoma e Shkallës së Parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit, nr.01.3.2.2/775; 517; 1027/2019 i datës 26.08.2021 të Doganës së Kosovës në Prishtinë, në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 27.09.2023 e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin padinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke e anuluar aktvendimin e kontestuar dhe është obliguar e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë që paditësit “Mili Company” ShPK me seli në Prishtinë, t'ia kthej shumën 13,379.14€ (trembëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë euro e katërbëdhjetë cent), të paguar më tepër, në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratave Unike Doganore me nr. R-471/22.01.2019, R-72/08.01.2019 dhe, R-32069/21.11.2018 të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prishtina 3.

Dhoma e shkallës së parë-Departamenti Fiskal, pasi vlerësoi aktvendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave si dhe dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës, vendosi që ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit. Me arsyetim se gjykata ka konstatuar se e paditura vendimin kontestues ndonëse e ka nxjerr në ri procedurë duke vepruar në zbatim të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.677/18 të datës 22.06.2021, ajo nuk i ka respektuar pikëpamjet juridike të Gjykatës, pra ka nxjerr vendim në kundërshtim me udhëzimet dhe vërejtjet e Gjykatës duke anashkaluar kështu detyrimet ligjore nga neni 65 i LKA-së. Sipas të paditurës Dogana e Kosovës ka analizuar çmimet e mallit të deklaruar dhe ka hulumtuar për vlerën e mallit të njëjtë/ngjashëm të zhdoganuar më herët si çmimet në dosje të vlerës dhe mbi bazën e analizave të tilla ka rezultuar se vlera e deklaruar është vlerë më e ulët se vlera reale e mallit lëndor. Për gjykatën një konstatim i tillë ka qenë i pa qëndrueshëm dhe në kundërshtim edhe me

udhëzimet e dhëna nga gjykata kur rasti është kthyer në rivendosje. Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimit të vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit ka caktuar ekspertizë financiare në kontest administrativ me ekspertin V.H.. Ekspertja financiare në ekspertizën e datës 14.07.2023, plotësim ekspertizën financiare të datës 02.10.2023 dhe në sqarimet e dhëna në seancë ka konstatuar se mjetet e paguara më tepër për shkak të rivlerësimit të DUD-ve kontestues janë 13,379.14€. Tutje ka theksuar se transaksionet bankare ndërkombëtare janë me status të ekzekutuar, janë në përputhje me faturat e DUD-ve kontestues dhe atyre jo kontestues. Gjykata nga shkresat e lëndës ka vlerësuar se me asnjë provë nuk është provuar konstatimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar, sipas të cilit vlera e deklaruar e mallit lëndor nga paditësi, nuk është vlera reale e paguar e mallit me qëllim importi në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDAK-së. Gjykata ka konstatuar se shuma e paguar më tepër nga paditësi prej 13,379.14€ në emër të detyrimeve doganore si pasojë e vlerësimit të mallit nga e paditura u konstatua nga plotësim ekspertiza financiare e datës 02.10.2023 e ekspertit financiar V.H. e cila shumë korrespondon plotësisht edhe me parashtrësën e Doganës të quajtur ekspertiza nr.1813/17.08.2023 e deponuar nga përfaqësuesi i saj në seancën e datës 27.09.2023. Gjykata ka vlerësuar edhe deklaratimet dhe provat e tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës por konstatoi se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Qëndrimin juridik të Dhomës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje Dhoma e Shkallës së Dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Dhoma e Shkallës së Parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), në drejtim të pretendimeve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, ky pretendim nuk qëndron me që gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme edhe përmes ekspertizës financiare dhe plotësimit të saj, që do të thotë se gjatë vlerësimit Dhoma e Shkallës së Parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe KDAK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, konstatimi i gjykatës është i pa bazuar dhe në kundërshtim me dispozitat e Kodit Doganor, ku kompetenca për caktimin e vlerës së mallrave të importuara është kompetencë e Doganës së Kosovës në procedurë doganore dhe në bazë të analizimit të DUD-ve kontestues shihet se deklaruesi i mallit ka deklaruar mallin me çmim më të ulët dhe se Dogana e Kosovës ka disponuar me të dhëna për atë lloj të mallit, çmime të marra nga të dhënat e disponueshme, zhdoganimet e mëhershme të mallit dhe në bazë të tyre ka ardhur deri të çmimi i caktuar për mallin lëndor kontestues, kolegji vlerëson se pretendimet janë të paqëndrueshme pasi

që Dhoma e Shkallës së Parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të bazuara. Sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë aktvendimi i organit administrativ i të paditurës nuk është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Dhoma e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, bazuar në shkresat e lëndës, po ashtu nuk ka gjetur asnjë provë konkrete që dëshmon konstatimin se paditësi ka deklaruar vlerë më të vogël se sa vlera reale e paguar për eksport në vendin tonë. Meqë e paditura nuk ka dëshmuar me prova konkrete se paditësi ia ka paguar eksportuesit të mallit vlerën më të vogël se sa vlera e deklaruar me DUD-at kontestues dhe faturat përcjellëse të mallit lëndor. Pretendimet ankimore se kontrata e shitblerjes nuk korrespondon në kohë me faturat e mallit kontestues, prandaj Dogana e Kosovës lidhur me mallin lëndor ka bërë analiza të çmimeve duke konkluduar se çmimet e prezantuara nga paditësi nuk mund të pranohen si reale dhe se Dogana në bazë të të dhënave të disponueshme nga Dosja e Vlerës ka bërë vlerësimin e mallrave, informata këto mjaftë të besueshme që pasqyrojnë vlerën reale të mallit lëndor kontestues, kolegji këto pretendime nuk i aprovoj sepse me dispozitat ligjore të nenit 31 par.1 të KDAK-së nuk thuhet se vlera doganore e mallrave të importuara duhet të jetë e njëjtë me vlerën e mallrave të marra nga Dosja e Vlerës por shprehimisht përcaktohet : *“vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit që paraqet çmimin e vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur sipas nevojës në përputhje me nenet 36 dhe 37”*. Ndërsa sipas dispozitës së nenit 123 par. 1 pika (a) të Udhëzimit Administrativ 11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave nr. 03/L-109, është parashikuar që dokumenti që duhet të bashkangjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë të mallit është *“fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”*. Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, kjo gjykatë gjen se Dhoma e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur është bazuar në dispozitat e ligjit nr.03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.04/L-099 dhe në dispozitat ligjore të nenit 46 par 2, 4 dhe 5 të LKA-së, kur ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se Dhoma e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Dhoma e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së Shkallës së Parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se Dhoma e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhoma e Shkallës së Dytë**  
**K.DH.SH.II.nr.1558/23, me datë 08.05.2024**

**Kryetar i kolegjit,**  
**Faton Bajrami**